



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 32/11

Prishtinë, më 25.10.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Duda Balje, Sali Asllanaj, Hykmete Bajrami, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Albana Fetoshi dhe Muhamet Mustafa.

Mungoi: Xhevdet Neziraj

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Daut Xhemajli-zëvendësministër i Drejtësisë, Arben Gashi-kryetar i Komisionit për Legjislacion, Lulzim Aliaj-Ministria e Drejtësisë, Agim Krasniqi-Drejtor i buxhetit Ministria e Financave, Menderes Ibra-Ministria e Financave, Rejhane Zylfijaj dhe Ramadan Islami-GIZ, monitorues nga KDI dhe OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Aurora Ademi dhe Njomza Halilaj (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndihmë juridike falas;**
I ftuar: Hajredin Kuçi, Minister i Drejtësisë;
I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;
I ftuar: Arben Gashi, Kryetar i Komisionit për Legjislacion;
- 3. Shqyrtimi i projektligjit nr.04/L-52 për marrëveshje ndërkombëtare, me raportin me amandamente të Komisionit Funkcional për Punë të Jashtme;**
- 4. Shqyrtimi i projektligjit nr. 04/952/L-61 për shitjen e banesave për të cilat egziston e drejta banesore;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës.

Jelena Bontic, kërkoi që pika e 4-të e rendit të ditës të shtyhet për ndonjë mbledhje tjetër, pasi që Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka angazhuar një ekspert për analizuar draftin dhe të jep ekspertizën e tij.

Komisioni me katër vota për (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Duda Balje, Latif Gashi dhe Hasime Krasniqi), tri vota kundër (Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj dhe Albana Fetoshi) dhe një abstenim (Muhamet Mustafa), vendosi që pika e katërt e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Rendi i ditës u miratua me këtë ndryshim.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për ndihmë juridike falas

Kryetarja, theksoi se Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka vlerësuar se projektligji përmban implikime buxhetore dhe duhet amendamenti i dispozitave përkatëse, për të shmangur implikimet buxhetore në zbatimin e tij. Me ligj thuhet që honorarët të përcaktohen me rregullat e brendshme të Kuvendit. Mirëpo, Kuvendi nuk ka rregulla të brendshme që merren me çështjen e pagave dhe të mëditje. Kuvendi ka rekomanduar që kjo pikë të shqyrtohet bashkarisht në mes të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Komisionit për Legjislacion dhe përfaqësuesit nga ministrinë përkatëse.

Lulzim Aliaj, theksoi se komision për ndihmë juridike falas është formuar dhe ka funksionuar me rregulla të UNMIK-ut (2006), është i pavarur dhe i përgjigjet Kuvendit. Nga Qeveria është rekomanduar që duke e pasur parasysh ndjeshmërinë e këtij komisioni ai duhet të vazhdojë t'i raportoj Kuvendit. Problemi qëndron në mënyrën e funksionimit: a do të jetë zyre apo do të shndërrohet në agjencion dhe ky është një problem i cili i takon administratës së brendshme. Sa i përket kostos buxhetore komisioni i ka 21 të punësuar dhe 5 zyre regjionale të cilat financohen nga Buxheti i Kosovës. UNDP-ja i ka financuar 5 zyre të tjera regjionale dhe 15 të punësuar, mirëpo, financimi nga UNDP-ja përfundon në fund të këtij viti, prandaj Komisioni për Ndihmë Juridike falas propozon që këto zyra dhe këta nëpunës të përfshihen në kuadër të kësaj agjencie. Mirëpo, duke pasur parasysh kushtet e FMN-së dhe fazën e monitorimit në të cilën jemi, Ministria e Drejtësisë është pajtuar që kjo Agjenci të vazhdojë punën me të punësuarit aktual, në mënyrë që të mos ngarkohet buxheti edhe pse këto zyre dhe këta nëpunës janë të nevojshëm .

Menderes Ibra, theksoi që Ministria e Financave pajtohet me politikat e Ministrisë së Drejtësisë, pasi që më e rëndësishmja është që të mos dilet nga kufijtë e buxhetit të caktuar, sepse siç shihet krijimi i Agjencionit dhe Këshilli i cili do ta monitorojë atë që është paraparë në projektligj në një fazë të mëvonshme do të reflektojë në ngritje të shpenzimeve .

Arben Gashi, veçoi dy probleme: problemi i parë është procedural dhe kërkesa e Komisionit për Buxhet dhe Financa për shtyerje për shkak të implikimeve buxhetore, e që në fakt është dashur të gjatë leximit të parë të theksohet se ky projektligj ka implikime buxhetore, sepse leximi i dytë merret me amendamentet, dhe amendamentet që janë propozuar nga Komisioni për Legjislacion nuk kanë asnjë implikim buxhetor. Kurse, problemi i dytë ka të bëjë me arsyetimin e ministrisë. Në ligj thuhet se zyrat rajonale janë në tërë territorin e Kosovës dhe nuk thekson askund se ato zyre dhe numri i punëtorëve kalojnë në kuadër të agjencionit.

Lulzim Aliaj, sqaroi që gjendja aktuale është që këto zyre dhe këta nëpunës nuk do të financohen më nga UNDP-ja dhe këto do të duhej të kalojnë në kuadër të këtij komisioni. Kjo formë është rregulluar më një rregullore të brendshme që ka funksionuar deri tani

Arben Gashi, pyeti se pse është ndalur ligji, përderisa këto struktura dhe implikime nuk janë të përmendura në ligj?

Kryetarja, theksoi se çështja është tek zyrtarizimi i të punësuarve të cilët janë paguar nga UNDP-ja. Përndryshe neni 40.7 rregullon çështjen e kalimit të nëpunësve, drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë aktual të Komisionit në kuadër të Agjencisë. Deklarata financiare që ka ardhur nga Ministria e Financave e cila është bazuar në deklaratën e Ministrisë së Drejtësisë ka paraparë të zyrtarizohen ata punëtorë që janë paguar nga UNDP-ja. Çështja është që ligji nuk mund të ngarkohet me 30 punëtorë të rinj, ashtu siç është paraqitur në deklaratën financiare.

Arben Gashi, theksoi përsëri që kjo gjë nuk është e paraparë me ligj dhe se ligji nuk është dashur të ndalet. Ligji thotë që punëtorët aktual që kanë kontratë në Komision të kalojnë në Agjencion, kurse të tjerët jo.

Kryetarja, theksoi se janë edhe disa çështje që është dashur të rregullohen nga komisioni funksional, si çështje e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit, ku thuhet se ata zgjidhen në bazë të rregullave të brendshme të Kuvendit, kur dihet se nuk ka rregulla të brendshme të Kuvendit për këtë qëllim. Kjo çështje po shkakton konfuzitet të neni tjetër i cili ka të bëjë me financat, sepse thotë që pagat e anëtarëve të Këshillit caktohen në bazë të rregullores së brendshme të Kuvendit.

Arben Gashi, sqaroi se ka rregulla të brendshme të Kuvendit të cilat i kanë përdorur disa komisione tjera për zgjedhjen e anëtarëve të njëjta.

Muhamet Mustafa, theksoi që kur është bërë leximi i parë ministria është dashur të thotë që ka pasur implikime financiare dhe ky ligj të mos shkojë më tutje ose zgjidhja tjetër është që ligji të kthehet prapa.

Kryetarja, sqaroi që sipas rregullores së punës Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk obligohet t'i shqyrtojë implikimet buxhetore para se ato të kalojnë në lexim të parë. Ne kemi raste kur propozojmë amendamente të projektligjit që kanë implikime buxhetore dhe rekomandojmë që të miratohet projektligji.

Naser Osmani, theksoi se Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk i shqyrton vetëm amendamentet e komisionit funksional, por i shqyrton të gjitha nenet në draft ligj. Ajo çka është më rëndësi është që të merremi më shumë me nenin 15, 20, 21, 22, 31, 37 dhe 39 sepse jo vetëm që kanë implikime buxhetore por edhe formulimi i tyre nuk përkon me atë të financave publike.

Hykmete Bajrami, konsiderojë që ligji është i rëndësishëm dhe nuk do të jetë kundër aprovimit të tij. Por, më duhet të theksojë patjetër që ky është degradim i situatës që është tani. Ne kur i sjellim projektligjet, gjithmonë i sjellim për përmirësimin e situatës. Aktualisht egzistojnë 21 të punësuar dhe 5 zyre regjionale në kuadër të komisionit dhe 5 zyre të tjera me 15 të punësuar të cilët financohen nga UNDP-ja, i cili financim po pritet të përfundojë dhe të punësuar do të mbeten pa punë. Komisioni shndërrohet në Agjencion, por numri aktual i të punësuarve është shumë më i vogël, e ligjet bëhen që të përmirësohet situata. Konsiderojë që punën që e kanë kry këta 36 të punësuar nuk do të munden ta kryejnë këta 21 të punësuar.

Agim Krasniqi, theksoi se është i mendimit që këto zyre mund t'i kryejnë të gjitha punët me këto kapacitete aktuale. Gjithashtu tregoi që janë duke e bërë një rishikim të strukturës dhe vërejtja

kryesore është tek avancimi i këtyre strukturave në nivele më të larta të cilat janë të panevojshme dhe po shkaktojnë kosto të pa përballueshme për buxhetin e Kosovës.

Lulzim Aliaj, theksoi se kalimi nga zyra në Agjension nuk shkakton asnjë kosto shtesë, sepse udhëheqësi i zyrës paguhet njëjtë sikur sekretari që është me pagë të njëjtë dhe do të jetë Kryeshf ekzekutiv.

Naser Osmani, tha se ne duhet të kemi një konsensus. A do të jetë ky organ në kuadër të ministrisë së Drejtësisë apo në kuadër të Qeverisë? Sepse, komisionet nuk janë të barabarta me Agjencionet sa i përket shpenzimeve, sepse çdo agjencion e ka koston e vet. Pra, ne duhet të kemi një ligj të përballueshëm dhe funksional.

Arben Gashi, theksoi se nëse e shikojmë në mënyrë konceptuale se a duhet të ketë agjencion apo jo, ligji duhet të kthehet në Qeveri, sepse Qeveria vendos për këtë çështje. Me sa unë po shoh, përfaqësuesi i ministrisë së Drejtësisë po insiston që implikimet financiare po ndodhin për shkak të zyrave rajonale. Në ligj nuk shkruan askund për këto zyre, por ato janë të rregulluara me një marrëveshje nënligjore. Dhe, faktikisht ne jemi në një situatë që ose duhet ta qojmë ligjin përpara me gjithë këto komplikime, ose ta kthejmë atë në Qeveri. Prandaj, ne si Komision për Legjislacion kemi rekomanduar që ligji t'i kthehet sponsorizuesit, por meqë ju keni kërkuar që ta shqyrtojmë edhe njëherë, atëherë po e shqyrtojmë.

Kryetarja, theksoi se zyret mobile për ndihmë juridike falas në ligj thotë se formohen nga Këshilli me propozim të drejtorit. Detyrë e jona është që brenda amendamenteve që kanë ardhur t'i rregullojmë implikimet buxhetore, miratimin e çështjes së buxhetit dhe të pagave.

Latif Gashi, theksoi se nga diskutimet po shihet se kemi një pajtueshmëri në mes të dy ministrive për kalimin e ligjit më tutje, dhe propozojë që ti shikojmë amendamentet dhe t'i bëjmë ndryshimet aty ku mundemi në mënyrë që ta harmonizojmë ligjin.

Hykmete Bajrami, theksoi se nuk është hera e parë që neve na vinë ligje me implikime buxhetore, me deklarata financiare i cili thotë që ky ligj të mos kalohet sepse ka implikime buxhetore, dhe ne prapë e kalojmë. Prandaj Qeveria duhet ta rregulloj atje ligjin dhe të mos e sjell në këtë gjendje. Ne nuk kemi nevojë të kryejmë një punë për të cilën të dy ministrit nuk janë harmonizuar në mes vete. Këta duhet të harmonizohen më njëri tjetrin, e pastaj të na sjellin ligjin në Kuvend

Daut Xhemajli, theksoi komision për buxhet dhe financa, mund të ndryshoni dispozitat e projektligjit dhe, që të shmangeni ndikimet buxhetore që janë vlerësuar dhe agjencionit të mund të funksionoj me këtë buxhet aktual që e ka.

Kryetarja, neni 15, nënparagrafi 1.3 parasheh që 'Këshilli për ndihmë juridike falas e propozon buxhetin e ndihmës juridike', propozoj që kjo pikë e nenit të fshihet sepse neni 22 e rregullon këtë çështje, sipas të cilit drejtori ekzekutiv propozon buxhetin e Këshillit.

Muhamet Mustafa, theksoi se ne duhet të tentojmë që ta qojmë ligjin përpara, mirëpo ligji parasheh transformimin e një komisioni në një Agjenci. Propozimi im është që në dispozitat aktuale të themi, "Agjencia hynë në fuqi më vonë, dhe ne punojmë me strukturat që i kemi tani, kurse më vonë pasi të shikohen implikimet buxhetore të filloj punën agjencionit".

Latif Gashi, theksoi se neni 15 1.3 e propozon buxhetin për ndihmë juridike falas. Ky Këshill e bënë vetëm propozimin por kush e bërë miratimin e këtij buxheti?

Agim Krasniqi, theksoi edhe një herë se ne dëshirojmë të ecim me ligjin. Neni 15 1.3 mund të hiqet sepse është një çështje e brendshme që mund të rregullohet dhe pika 22 e sqaron këtë çështje. Ju lusë që neni 22 pika 2.2 të rregullohet dhe propozimet duhet të shkojnë për të gjitha agjencionet në pajtim me ligjin e financave.

Komisioni me tetë vota për (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj dhe Hykmete Bajrami), një kundër (Albana Fetoshi) dhe një abstenime (Muhamet Mustafa) vendosi që të fshihet paragrafi 1 pika 3 e nenit 15.

Kryetarja, theksoi se neni 20 e rregullon pagesën e anëtarëve të këshillit sipas të cilit anëtarët e këshillit mbajnë mbledhje të rregullt një herë në muaj për të cilin e kanë të drejtën e pagesës sipas dispozitave të brendshme.

Agim Krasniqi, theksoi se asnjë akt juridik as në Qeveri, as në ministri as në Kuvend nuk e rregullon këtë çështje. Planifikimet buxhetore aktualisht jemi duke i bërë në bazë të një rekomandimi që ka ardhë nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, sepse akt tjetër juridik nuk ka.

Menderes Ibra, vlerësoi të rëndësishme që të zgjidhet problemi i pagesës së anëtarëve të bordeve të agjencive, qofshin të pavarura dhe ato që janë në varësi të qeverisë. Për agjencitë e pavarura, kategorizimi i bordeve të këtyre agjencioneve duhet bërë nga Kuvendi, ndërkaq për agjencitë tjera që janë në përgjegjësinë e qeverisë, do të rregullohen në kuadër të qeverisë. Ato do të mund t'i kategorizonim në tri kategori varësisht nga pesha e funksionit të tyre.

Komisioni me shtatë vota për (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj dhe Muhamet Mustafa), një kundër (Albana Fetoshi) dhe një abstenim (Hykmete Bajrami), neni 20, paragrafi 1, 2 dhe 3 u ndryshuan.

Kryetarja, propozoi që në nenin 22, nënparagrafi 2.2, fjala "Këshillit", të zëvendësohet me fjalën "Agjencisë". Gjithashtu propozoi që nënparagrafin 2.3. të nenit 22, të fshihen fjalët "**për të punësuarit e ardhshëm**".

Komisioni njëzëri votoi për ndryshimet e bëra në nenin 22, nënparagrafin 2.2. dhe 2.3.

Kryetarja, propozoi që neni 37, paragrafi 1 riformulohet si në vijim: "Agjencia financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës në pajtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë". Gjithashtu propozoi që paragrafi 2 i këtij neni të fshihet në tërësi.

Komisioni me nëntë vota për (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj dhe Muhamet Mustafa), asnjë kundër dhe një abstenim (Hykmete Bajrami), votoi ndryshimet e bëra në nenin 37, paragrafi 1 dhe 2.

Kryetarja, propozoi që të fshihet neni 39, që ka të bëjë me të hyrat vetanake, pasi që kjo çështje rregullohet me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Komisioni njëzëri votoi fshirjen e nenit 39.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

1. Projektligji nr. 04/L-017 për ndihmë juridike falas, nuk përmban implikime buxhetore shtesë, me përjashtim të nenit 15 nënparagrafi 1.3., nenit 20 paragrafi 1 dhe paragrafi 3, nenit 22 nënparagrafi 2.2. dhe nënparagrafi 2.3., nenit 37 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 dhe nenit 39.
2. Me qëllim të shmangies së ndikimeve buxhetore në implementimin e këtij ligji, Komisioni propozon amendamentimin e dispozitave të projektligjit, si në vijim:

Amendamenti 1

Neni 15, nënparagrafi 1.3., fshihet

Amendamenti 2

Neni 20, paragrafi 1 riformulohet si në vijim:

1. Anëtarët e Këshillit mbajnë mbledhje të rregullt sipas nevojës për të cilën gëzojnë të drejtë në meditje.

Neni 20, paragrafi 2, fjala "*honorar*", zëvendësohet me fjalën "**mëditje**".

Neni 20, paragrafi 3, fjala "*honorar*", zëvendësohet me fjalën "**mëditje**".

Amendamenti 3

Neni 22, nënparagrafi 2.2, në rreshtin e dytë fjala "*Këshillit*", zëvendësohet me fjalën "**Agjencisë**".

Neni 22, nënparagrafi 2.3., në rreshtin e dytë fshihet fjala "**për të punësuarit e ardhshëm**"

Amendamenti 4

Neni 37, paragrafi 1 riformulohet si në vijim:

"Agjencia financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës në pajtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë"

Neni 37, paragrafi 2, fshihet ne tërësi.

Amendamenti 5

Neni 39, fshihet në tërësi.

3. **Shqyrtimi i projektligjit nr. 04/L-52 për marrëveshje ndërkombëtare, me raportin me amandamente të Komisionit Funkcional për Punë të Jashtme;**

Komisioni njëzëri nxorri këtë:

R E K O M A N D I M

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

4. Të ndryshme

4.1. Kryetarja, njoftoi anëtarët e komisionit për takimin që do të mbahet më datën 28.10.2011 në ora 10:00, në mes KBF dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) ku do të sqarohen dy projektet që kanë të bëjnë me ngrohtore dhe ujësjellës.

4.2. Kryetarja njoftoi se një delegacion Britanik në Unionin Ndërparlamentar, do të vizitojë Kosovën në muajin nëntor dhe ka kërkuar të takohet me Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe Komisionin për Mbikëqyerjen e Financave Publike, më datë 16.11.2011.

Mbledhja përfundoi në orën 12:50

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona